

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, Vesellismajli, dhe Suzana Çerkini - anëtarë, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit F.Xh., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328/1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së ish Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë PP.nr.814-2/2006 dt. 05.08.2009, pas shqyrtimit gjyqësor mbajtur me datë 04.04.2018, në të cilin të pranishëm ishin prokurori i shtetit – Hivzi Bajraktari, i pandehuri F.Xh., gjykatanë vështrim të nenit 365 të KPPRK-së, pas seancës për këshillim dhe votim në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### AKTGJYKIM

#### I pandehuri:

**F.Xh.**, i biri i N. dhe Sh., e gjinisë K., i lindur me dt..., në fshatin M., Komuna P., i martuar, baba i gjashtë fëmije, ..., i gjendjes së dobëtekonomike, ..., me numër personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

**Sepse:** Me datën 12.10.2006 rreth orës 22:00, në P. në rrugën “A.Rr.”i pandehuri e ka kanosur me armë zjarri – revole, N. (Rr.) L., nga fshati D. Komuna P., me këtë rast policia ia kishte konfiskuar të dyshuarit një revole CërvenaZastava – cal-7.65 mm, MOD-70, me numër serik C-151144, prodhim jugosllav, ngjyrë e zezë, me karaikator me pesë fishek si dhe një fishek në tytë,

- me këtë ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328/1 të KPK-së

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 3,11,15,34,35,36,41,42,43,44,64 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK –së, e gjykon:

### DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit F.Xh., i caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej **6(gjashtë)muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën prej **1 (një) vit**.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 euro, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 69 të KPRK-së dhe konform nenit 115 të KPPRK-së konfiskohet: (1)njërevole, CërvenaZastava – cal-7.65 mm, MOD-70, me numër serik C-151144, prodhim jugosllav, ngjyrë e zezë, me karaikator me (6) fishek.

I dëmtuari N. (Rr.) L., nga fshati D. Komuna P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria e Qarkut në Prishtinë ka ngritur aktakuzën PP.nr.814-2/2006 dt. 05.08.2009, me të cilën ka akuzuar të pandehurin F.Xh. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328/1 të KPK-së.

Me datë 04.04.2018, kjo gjykatë ka caktuar dhe mbajtur seancën gjyqësore në këtë çështje penale në të cilën ishin të pranishëm prokurori i shtetit Hivzi Bajraktaridhe pandehuri, në të cilën seancë prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën PP.nr.814-2/2006 dt. 05.08.2009, ndërsa Kryetari i Trupit Gjyqësor pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarojë i pafajshëm.

I pandehuri F.Xh., në shqyrtim gjyqësor deklaroj se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihej në barrë.

Prokurori i shtetit pas deklarimit të të pandehurit, u pajtua me pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë, Gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së ; i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza siç janë: vërtetimi mbi konfiskimin e armës i datës 12.10.2006, sidhe dokumentacioni tjetër që gjendet në shkresat e lëndës.

Gjykata pas marrjes së vendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, kaloi në fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i Shtetit Hivzi Bajraktarinë fjalën e saj përfundimtare deklaroise: ne seancën e shqyrtimit gjyqësore i pandehuri e pranojë fajësinë për veprën penale të përshkruar si ne akuze me çka u vërtetua se i njëjti ka kryer veprën penale nga neni 328/1 të KPK-së, dhe mbetet në tërësi pranë akuzës, dhe i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit, po ashtu i ka propozuar trupit gjyqësor që si rrethane lehtësuese të merr pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

I pandehuri F.Xh. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se është penduar për veprën e kryer, ndërsa me të dëmtuarin prej asaj kohe nuk kanë pasur problem.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 64 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga i pandehuri, rrethanat e tij familjare, i njëjti është i martuar baba i gjashtë fëmijëve, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, nuk ka të dhëna se ka qenë i dënuar më parë, sjelljen e tij korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim me burg prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën prej 1 (një) vit, si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të

pandehurit, rrethanat në të cila është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor bazuar në nenin 69 të KPRK-së dhe konform nenit 115 të KPPRK-së.

Konform nenit 463 par.2 të KPRK-së, Gjykata të dëmtuarin N. (Rr.) L., nga fshati D. Komuna P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**P.nr374/09, datë 04.04.2018**

**Sekretarja Juridike:**  
**Shqipe Rexhepi**

**Gjyqtari:**  
**Arben Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.